U.F.O UNIVERSITY

UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

OPTIME

REVISTË SHKENCORE E U.F.O UNIVERSITY

Nr. 1

DHJETOR 2010

www.albanianuniversity.edu.al

KËSHILLI BOTUES
Prof. dr. Hamit BORIÇI (Kryetar)

ANËTARË
Prof. dr. Afrim KARAGJOZI
Prof. dr. Afrim TABAKU
Prof. dr. Enver FAJA
Prof. dr. Nesti KONDILI
Prof. dr. Nuri ABDIU
Prof. dr. Skënder DURRËSI
Prof. as. dr. Gjon BORIÇI
Prof. as. dr. Qamil TALKA
Prof. as. dr. Viktor TOPULLI
Dr. Çerçiz MINGOMATA
Dr. Eriona KATRO
Dr. Erion PICIRI
Dr. Fatmir TARTALE

REDAKSIA
Prof.dr.Pavli Kongo Kryeredaktor
Agron Pullumbi Redaktor përgjegjës

ANËTARË
Prof. dr. Afrim TABAKU
Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj
Prof. dr. Nuri ABDIU
Prof. dr. Pirro CIPO
Prof.as. Hasan JAHO
Prof. as. Sopot CAMA
Ma. Denis MARI
Ma. Dorian KOÇI
Ma. Jorida FRAKULLA
Ma. Nuri XHEPA
Arkitekt Athanas NDREÇKA

DREJTORE PËR BOTIMIN

Ma. Valbona NATHANAILI

Korrektor gjuhësor
Ma. Natasha LUSHAJ
Faqosja
Gledi KAPLLANAJ
Besnik Frashni
Ideja dhe kompozimi i kopertinës
Agron PULLUMBI

ISSN 2220-461X

e-mail: ufopress@yahoo.com
nuri.xhepa@yahoo.com

Përmbajtja

EDITORIAL
Duke hedhur hapin e parë promovues ... 3
Prof.dr. Pavli KONGO
ARTIKUJ, STUDIME DHE KËRKIME
Përdorimi i flokëve si bioindikatorë të ekspozimit të fëmijëve ndaj elementeve gjurmë
Prof.dr. Afrim TABAKU, UFO University ... 5
Ndikimi i Bashkimit Evropian mbi disiplinën e konkurrencës
Dr. Eriona KATRO, UFO University ... 10
Zhvillimi i të drejtave natyrore
Dr. Jorida XHAFAJ, UFO University ... 21
Fenomeni i deideologjizimit partiak
Ma. Roland LAMI, UFO University ... 28
Fuqia e historisë
Prof.as.dr. Gjon BORIÇI, UFO University ... 42
Dy pamje të eseistikës së Nolit
Prof.dr. Hamit BORIÇI, UFO University ... 53
Kreditimi i ekonomisë shqiptare
Msc. Ingrid KONOMI, UFO University ... 65
Prof.asc. dr. Vjollca KARAPICI
Imazhi i Shqipërisë dhe i shqiptarëve në veprat e udhëtarit dhe diplomatit anglez William Martin Leake ... 75
Ma. Dorian KOÇI, UFO University
Kriza globale, defiçiti buxhetor dhe problematika e politikave fiskale në Shqipëri
Ma. Niko LERA, UFO University ... 85
Zbatimi i provës së shpejtësisë së tretjes në katër formulime të ndryshme të tabletave të paracetamolit
Prof.dr. Skënder DURRËSI, , UFO University ... 103
Prof.as.dr. Bedri ABDULLAHU, Universiteti i Prishtinës
Sistemet zgjedhore në Shqipëri
Ma. Afrim KRASNIQI ... 106
Psikologjia e turizmit
Ma. Zhaneta LACAJ, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër ... 127

OPINIONE dhe KOMENTE
Veprimtaria dhe prodhimtaria shkencore, tregues shumë i rëndësishëm për përcaktimin e rangut të një universiteti
Prof.dr. Halil SYKJA, Universiteti i Tiranës ... 131
Aspekte të procedimit penal në luftën kundër krimit ekonomik në këndvështrimin ndërkombëtar
Dr. Fatmir TARTALE, UFO University ... 134
Ma. Gerti TARTALE, Jurist

Diplomacia (si një element i fuqisë së një shteti) ... 145
M.Sc. Ermela HYSA, Departamenti i Shkencave Politike, U.F.O University

ESSE, PUNIME TË STUDENTËVE
Rivlerësimi arkitekturor dhe hapësinor i Muzeut historik kombëtar ... 151
Olsi MINO, student i Departamentit të Arkitekturës, UFO University

PROGRAME STUDIMORE DHE PLANE MESIMORE
Probleme të organizimit e të cilësisë së kërkimit në universitete ... 157
Prof.asoc.dr. Vaso QANO, Programi TEMPUS
Ma. Nuri XHEPA, UFO University,
Shërbimet publike, koncept teorik dhe përgjegjësi shoqërore ... 170
Dr. Arlinda YMERAJ, UNICEF
Procesi projektues në arkitekturën bashkëkohore ... 185
Dr. Daniel GURALUMI, UFO University

FIGURA, PERSONALITETE SHKENCORE
Akademiku Bedri Dedja - mësues i mësuesve dhe profesor i profesorëve të fushës së tij ... 193
Prof.dr. Nuri ABDIU, UFO University

PROJEKTE TEKNIKA dhe TEKNOLOGJI
E-learning ... 198
Ma. Denis MARI, UFO University
Biblioteka universitare
Valbona NATHANAILI, UFO University ... 202

JETA SHKENCORE
Diplomat e para të arkitekturës të një universiteti jopublik "UFO University" 207
Prof.dr. Enver FAJA, UFO University
Forum: Gjuha në media, marrëdhëniet mes medias dhe gjuhës shqipe ... 211

SISTEMET ZGJEDHORE NË SHQIPËRI

ELECTORAL SYSTEMS IN ALBANIA

Ma. Afrim KRASNIQI

Abstract

Democratic elections have been practiced for only two decades out of one hundred years of history of the Albanian state. During the other eight decades Albanian leaders have either been appointed or elected in sham elections. From 1991 until 2009 was an experimental period, in which the political elite has looked for a stable and effective electoral law in order to strengthen the rule of law and democratic state. Transition from majoritarian to mix to proportional electoral formulae occurred during seven election cycles. As a result, there was little time for the electorate and election's administration to fully implement the electoral laws and understand their outcomes. The political decision-makers changed the Albanian Constitutions three times, while the electoral law 15 times to satisfy their political goals of the moment. No long-term agreement about the electoral law has been achieved yet. Each election law changed the electoral formula and election administration procedures imposing unstable and fragile party coalitions. A determining factor for the length of democratic transition and defectuous elections has been the lack of will of political decision-makers and election administrators. The lack of political will bring about the failure of the political system. This study analyses the problems associated with the electoral system in Albania and suggests few ways to improve them.

SISTEMET ZGJEDHORE NË SHQIPËRI

Institucioni i zgjedhjeve demokratike ka një përvojë modeste në historinë e shtetit shqiptar. Gjatë 100 viteve shtet kemi vetëm një periudhë gati dy dekadash të praktikave demokratike zgjedhore, ndaj tetë dekadave pa zgjedhje konkurruese, me zgjedhje fiktive ose me pushtet legjislativ të emëruar. Praktika zgjedhore e tranzicionit 1991-2009 mbetet periudha e eksperimentimit permanent në kërkim të një sistemi zgjedhor të qëndrueshëm dhe efektiv, si bazë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe sistemit politik demokratik. Kalimi nga sistemet e skajshme zgjedhore (mazhoritar - miks - proporcional) brenda vetëm shtatë proceseve zgjedhore praktikisht nuk krijoi hapësirë

e kushte reale për aplikimin tërësor dhe integral të asnjë sistemi konkret.

Aktorët politikë vendimmarrës ndërhynë tre herë në Kushtetutë dhe ndryshuan 15 herë legjislacionin zgjedhor në kërkim të një kuadri zgjedhor të përshtatshme për ambiciet politike të momentit, duke mos arritur kompromis mbi një zgjidhje afatgjatë e të qëndrueshme. Çdo proces zgjedhor pati ndryshime në sistemin zgjedhor dhe formulën e përkthimit të tij në mandate parlamentare duke imponuar sisteme partiake të brishta dhe të paqëndrueshme. Faktor përcaktues për tranzicionin dhe problematikën zgjedhore u bë mungesa e vullnetit politik nga aktorët konkurrues, të cilët kanë edhe monopolin mbi administrimin zgjedhor. Pa këtë vullnet çdo sistem është i destinuar të dështojë. Studimi analizon problematikën dhe sugjeron rekomandime konkrete në funksion të shndërrimit të zgjedhjeve në institucion efektiv, mbartës i sovranitetit dhe i jetësimit të demokracisë në Shqipëri.

Rreth 30 vjet më parë, studiuesi estonez Rein Taagepera shkruante[1] se *"rregullat zgjedhore mund të bëjnë ose zhbëjnë një parti – ose një shtet"*. Në dukje e ashpër dhe kundërshtuese ndaj thelbit të institucionit të zgjedhjeve, *"zgjedhjeve të lira, të fshehta e demokratike për alternativën më të mirë"*, ky përcaktim gjen, në gjuhën dhe në vendin tonë, një terren real të bërjes dhe zhbërjes së shtetit e të partive. Krizat politike të viteve 1991 e 1997, zhvillimet e tensionuara politike të viteve 1996, 2001, 2007 dhe, së fundi, edhe më '2009, si dhe në tërësi tranzicioni i gjatë me një demokraci ende të brishtë, të pakonsoliduar dhe jo sa duhet funksionale, janë një dëshmi e shndërrimit të zgjedhjeve nga mekanizëm zgjidhjeje, në mekanizëm ruajtjeje ose marrje me çdo kusht e pushtetit.[2]

Në nenin 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, përcaktohet se; *"qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike"*. Sipas saj, *"sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit" dhe "populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti"*.
Tej këtij përcaktimi kushtetues, historia e zgjedhjeve dhe e proceseve elektorale shfaqet po aq e njëjtë, e brishtë dhe e shtrirë në kohë dhe në problematikë, sa edhe vetë historia e shtetit shqiptar. Me një shoqëri të vonuar në formimin qytetar dhe në zhvillimin ekonomik, me mungesë të theksuar të elitave politike dhe të modeleve referuese politike, ndryshe nga shumica e vendeve europiane, Shqipëria nuk pati revolucion ekonomik, shtresë sindikale dhe as elemente të tjera nxitëse të lëvizjeve politike, konkurrencës dhe garës midis grupeve shoqërore, klasave dhe niveleve përbërëse të shoqërisë.
Mungesa e një elite politike të ndërgjegjshme për rëndësinë e zgjedhjeve dhe produktit të tyre demokratik, mungesa e

[1] Rein Taagepera "Votat dhe mandatet: efektet dhe përcaktuesit e sistemeve zgjedhore", Tiranë2004.
[2] Afrim Krasniqi"Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008", Tiranë 2009.

institucionit të votës, e respektit ndaj mendimit të lirë, ndaj shumëllojshmërisë së informacionit, si dhe mungesa e vlerësimit të pavarur dhe disidencës së organizuar politike, ndihmuan procesin e kundërt, atë të dominimit hera-herës të një sistemi antivlerash, sipas të cilit, në kutitë e votimit nuk duhej kërkuar vullneti i lirë qytetar, por mekanizmi personal që ofron pushtet pakufi, ofron privilegje dhe të drejtën për të qeverisur sa më gjatë të jetë e mundur.

Në mënyrë të gabuar, gara elektorale në vendin tonë vijon të jetë larg parimeve universale të zhvillimit të zgjedhjeve, si shans për zgjidhje politike dhe shprehjen e vullnetit të lirë qytetar. Më shumë se garë legjitimiteti përvoja jonë elektorale i ngjan një dueli të ashpër, pa rregulla dhe parime, prej të cilit nuk pritet të dalë një platformë zhvillimi, por një fitues që i merr të gjitha dhe një humbës që i humb të gjitha.

Problemet e legjitimitetit të zgjedhjeve janë shndërruar më pas në probleme të legjitimitetit dhe të funksionimit të institucioneve produkte të zgjedhjeve. Zgjidhjet e munguara nga kutitë e votimit u kërkuan në forma të tjera, në protesta, në bojkot politik të institucioneve dhe, në raste tragjike si ai i vitit 1997, në veprime të dhunshme dhe mosbindje civile. Kostoja politike dhe ekonomike e brishtësisë dhe cenimit të institucionit të zgjedhjeve ishte aq e madhe, saqë Shqipëria humbi kohën e integrimit real europian në krahasim me vendet fqinje, të cilat gjatë këtyre dy dekadave ishin nxitëse, realizuese ose viktima të një ose më shumë luftërave civile dhe ndëretnike.

Përvoja shqiptare e periudhës së tranzicionit ka vërtetuar tezën e studiuesit spanjoll Jose Ortega y Gasset, sipas të cilit, *"e mira e demokracive, pa marrë parasysh tipin dhe shkallën e saj, varet nga një imtësi teknike: nga sistemi zgjedhor. Çdo gjë tjetër është dytësore"*.[3]

Një sistem zgjedhor solid, i besueshëm dhe i qëndrueshëm, demokratik dhe konkurrues, krijon shanse reale për një demokraci solide, funksionale dhe konkurruese. Përvojat e disa prej vendeve të suksesshme të Europës Lindore, si Polonia, Hungaria apo Çekia, lidhet dukshëm me aftësinë e tyre për të aplikuar modele elektorale që prodhojnë zgjidhje politike dhe sisteme politike efektive. Përvoja e vendeve të tjera problematike, sidomos e vendeve ish-komuniste të Europës Juglindore, ofrojnë modelin e kundërt, atë të krizave politike periodike, për shkak të problemeve me legjitimitetin dhe funksionimin e institucioneve politike, produkte të zgjedhjeve të kontestueshme.

Gjatë viteve 1991 – 2009 u aplikuan tri format universale të sistemeve zgjedhore, sistemi mazhoritar, sistemi miks dhe sistemi proporcional. Kalimi brenda dy dekadave nga një ekstrem në tjetrin, nga modeli mazhoritar në atë proporcional, pa i dhënë kohë asnjë sistemi të provohet dhe ushtrohet lirisht, me të gjitha elementet dhe brendësinë e tij, është shprehja më e qartë formale e mungesës së identitetit zgjedhor dhe të institucionit zgjedhor. Në raport krahasues, asnjë vend tjetër europian nuk bëri brenda një kohe kaq të shkurtër kalime të tilla ekstreme, gjë që shpjegon

[3] Carolyn P.Boyd "Historia patria:politics, history, and nationalindentity in Spain", Madrid 1997

edhe enigmat rreth tranzicionit shqiptar, i cili paraqet një shembull kritik dhe problematik në listën e vendeve të tjera ish-komuniste.
Në këto rrethana, sfida më e madhe e shoqërisë shqiptare edhe më tej mbetet vendosja e sistemit të vlerës, sistemit të konkurrencës së lirë, të respektit për mendimin dhe votën e tjetrit, të respektit ndaj vullnetit real të qytetarëve dhe, për rrjedhojë, për shndërrimin e institucionit të zgjedhjeve në institucion që nxit, promovon e prodhon stabilitet, progres dhe besim në sistemin politik dhe për sistemin politik.

Probleme të traditës zgjedhore (1912-1920)

Shqipëria paraqet vendin evropian, në të cilin institucioni i zgjedhjeve ka qenë e mbetet një nga institucionet më të dobëta, pa traditë, më të kontestuara dhe, për rrjedhojë, burim i krizave politike periodike. Në traditën zakonore shqiptare zgjedhja ishte një nocion pa kuptim. Në familjet tradicionale burri më i vjetër në moshë ishte njëherësh edhe njeriu drejtues i familjes. Ky parim aplikohej edhe për të zgjedhur familjen – bajrak, e cila drejton katundin apo lagjen. Kushti kryesor i fitimit të këtij statuti ishte të qenit familja më e pasur, dera më me shumë meshkuj dhe, njëherësh, familja më me shumë emër në zhvillimet brenda komunitare. Në familje drejtonte burri, në fis më i moshuari, në lagje familja më e pasur, në zonë fisi më i fuqishëm, në krahinë zona më e pushtetshme. Brenda këtyre shkallëve nuk mund të kishte votime apo zgjedhje, por vetëm bindje, pranim pa kushte dhe, pas vdekjes, trashëgim në vijë mashkulli të titullit e të fuqisë politike.
Me këtë traditë fisnore dhe logjikë të të fortit u ndesh edhe shoqëria shqiptare e vitit 1912. Në zgjedhjet formale në Perandorinë Osmane deputetët ishin produkt i këtyre faktorëve si dhe i vetëpërzgjedhjes, parapëlqimit të autoriteteve pushtuese e drejtuese osmane. Më 1912-ën, anëtarët e Kuvendit të Vlorës, të cilët vendosën edhe Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të ri shqiptar, tentuan të krijojnë një model të ri zgjedhor, duke hedhur hapat e parë konkret në krijimin e institucionit të zgjedhjeve.

Shembulli i parë ishte vetëzgjedhja e kryetarit të qeverisë (I. Qemali), votimi i fshehtë për zgjedhjen e tetë anëtarëve të qeverisë (me votim të fshehtë, nominal e konkurrues), si dhe votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Senatit (votim i fshehtë, nominal e konkurrues).
Ky koncept i votimit mbetet unikal, pasi asnjë qeveri tjetër në historinë më se 100-vjeçare të shtetit shqiptar nuk është zgjedhur përmes votimit nominal, konkurrues e të fshehtë midis emrave pretendues për ministra. Arritja megjithatë mbetej simbolike, jo vetëm për shkak të jetëgjatësisë së shkurtër dhe fatit të qeverisë së Vlorës, por edhe për shkak të ekzistencës së disa mekanizmave të përzgjedhjes brenda aktit të zgjedhjes. Kështu, vetë delegatët e Vlorës ishin të zgjedhur, praktikisht, përmes delegimit në emër të krahinave dhe, konkretisht, në emër të familjeve të mëdha drejtuese në këto krahina. Asnjë delegat nuk

u zgjodh me votim konkurrues apo formë tjetër të njohur në demokracinë moderne. Ata morën mandat formal nga ana e autoriteteve vendore dhe, kryesisht, nga familjet e mëdha. Aq e vërtetë është kjo, saqë, në rast pamundësie për pjesëmarrje të ndonjë emri nga familjet e mëdha shqiptare, kreu i familjes kishte të drejtën të delegonte djalin e tij ose një njeri tjetër të besuar. Kjo dukuri del qartë edhe në apelin ditor të delegatëve pjesëmarrës në Vlorë, ku përmenden shembuj të delegimit apo të dërgimit të një pinjolli familjar në vend të kryefamiljarit të caktuar për pjesëmarrje.

Shembulli i dytë lidhej me vendimin e qeverisë së Vlorës për miratimin e një ligji zgjedhor. Sipas këtij ligji, i pari në historinë e shtetit shqiptar,[4] çdo qytetar; *"që ka mbushë 21 vjeç, që ka të gjitha të drejtat civile dhe politike, që s'asht dënue me ndëshkim as për ndonjë krim, që paguen të dhjetën e ndonji tjetër dhanie, ose asht zoti nji prone a ndërtese, ose bir i një ati a nane që janë zot të nji prone të këtillë, ose asht në krye të administratës, të nji industrie a nji tregëtie, ka të drejtën të zgjedhë ulemanjtë, fetarët dhe nëpunësit e fesë, mësuesit, mjeksit, miset e gjykatoreve, nëpunësit e administratës së prefekturës, si dhe ata që kanë marrë diplomë dhe janë lejuem të bahen profesorë në një vënd të huej, sido që s'mbushin konditat që i treguem ma sipër, kanë të drejtë të zgjedhin"*. Të vetmet kategori kolektive që nuk mund ta ushtronin të drejtën e zgjedhjes ishin *"ushtarët, gjindarmët, policët"*. Nga e drejta e votës dhe e kandidimit përjashtoheshin gjithashtu femrat, duke u njohur vetëm meshkujve monopolin mbi institucionin e zgjedhjeve.

Në kriteret për zgjedhje (neni 60) theksohet se *"çdo shtetas që ka mbushë moshën njizet vjeç dhe që çdo vjet i paguen shtetit pesëdhjetë grosh taksë, me çdo titull qoftë, edhe që asht banues në krahinë e që zotënon tokë e plang në periferinë e krahinës, ka të drejtë të zgjidhet për dy vjet anëtar i këshillit të krahinës"*. Nga kjo e drejtë e kandidimit përjashtoheshin *"ata që janë shërbëtorë, ata që kanë humbur të drejtat civile tanësisht ose pjesërisht, të falimentuemit që s'e kanë rifitue kredinë, ata që kanë humbun mendjen e gjykimin, ata që janë dënue me nji vjet burgim për delikt, ose janë dënue për nji ndërshkim të barabartë me këtë, ata që janë dënue për vagabontazh, edhe ata që janë në shërbim të nji shteti të huej"*.
Sistemi i votimit ishte proporcional preferencial dhe rajonal, me dy shkallë. Sipas këtij sistemi,[5] *"bileta e votimit asht një fletë prej letre të bardhë. Çdo zgjedhës do të shkruejë me dorën e vet, e po s'diti me shkrue vetë, shkruen me anën e një të besuemi të tij, emnat e mbiemnat e disa njerëzve, numuri i të cilëve duhet të jetë baraz me nji të katërtën e numurit të anëtarëve që duhet të ketë këshilli i krahinës (neni 72)"*. Çdo arkë do të kishte 300 zgjedhës, kurse në fund të procesit, *"mbasi të provohet se nuk asht prekun në asnjë anë, shqepen vulat, hapet arka, këndohen nji nga nji biletat e votimit, shënohen emnat me radhë në nji listë dhe ata që kanë fitue vota ma shumë*

[4] Lef Nosi "Dokumente historike 1912-1920", Tiranë 2008.
[5] Lef Nosi "Dokumente historike 1912-1920", Tiranë 2008.

shpallen anëtarë të zgjedhun të këshillit të krahinës. Për ata që kanë fitue vota të barabarta, shtihet llogari". Ky mekanizëm zgjedhor përsëritej në të gjitha nivelet.

Duke e analizuar në retrospektivë, me kohën kur është miratuar ligji dhe, pavarësisht nivelit të zbatimit të tij, ligji, sistemi i votimit dhe kriteret për barazi, fshehtësi të votës, komisione shtetërore të pavarura, transparenca për listat e zgjedhësve e votat, procesi i animimit, etj., përbëjnë një arritje dhe një bazë të mirë tek e cila do të mbështeteshin pjesa më e madhe e regjimeve të tjera të pas viteve '920. Në një plan më të gjerë, parimet e sistemit zgjedhor dhe të zgjedhjeve të lira e konkurruese, më 1912-ën ishin një koncept me përhapje të gjerë në Europë dhe shtete të veçanta kishin krijuar një traditë gati 50-100 vjeçare të aplikimeve të tyre. Nga këto modele u udhëhoqën edhe krijuesit e ligjit të parë zgjedhor të vitit 1912.
Me largimin e qeverisë së Vlorës dhe ardhjen e Princ Vidit, u ndryshuan edhe rregullat zgjedhore. Kjo ishte e kuptueshme për një princ dhe një model qeverisës, i cili nuk ishte zgjedhje shqiptare, por produkt i imponuar nga Fuqitë e Mëdha. *"Statuti organik i Shqipërisë"*, parashikoi zgjedhjet të pjesshme për në Asamblenë Kombëtare, i cili do të ishte edhe parlamenti i Principatës. Sistemi elektoral mbeti i njëjtë, proporcional i personalizuar, me zgjedhje në dy shkallë. Parimisht, qytetarët me të drejtë vote kishin të drejtë të zgjidhnin një emër që dëshironin nga lista e kandidatëve të paraqitur. Sipas Kushtetutës së Principatës;[6] *"anëtarët e zgjedhur të Asamblesë Kombëtare zgjidhen me votim indirekt nga tre për çdo sanxhak"* dhe, *"që një njeri të zgjidhet ose të caktohet si anëtar i Asamblesë Kombëtare, i duhet të ketë shtetësinë shqiptare dhe vendbanim brenda kufijëve të Principatës".*

Teknikisht, zgjedhjet përfshinë të gjitha institucionet vertikale, që nga njësitë vendore, deri tek qeveria dhe mbreti.
Konkretisht; *"në nahijet këshilli komunal, i mbledhur nën kryesinë e mudirit, do të zgjedhë një delegat. Ky do të shkojë në kryeqendrën e kazasë dhe do të bashkohet me anëtarët e këshillit bashkiak dhe të këshillit të kazasë. Nën kryesinë e kajmekamit ky trup elektoral do të zgjedhë dy delegatë, të cilët do të shkojnë në kryeqendrën e sanxhakut, ku, në marrëveshje me anëtarët e këshillit bashkiak dhe të këshillit të sanxhakut dhe nën kryesinë e mytesarifit, do të zgjedhin me shumicë absolute përfaqësuesit për në Asamblenë Kombëtare".* Ligji ndalonte pjesëmarrjen në votime të kajmekamit, mytesarifit dhe të gjithë funksionarëve të emëruar nga qeveria. Ndalohej kandidimi për asamble i të gjithë funksionarëve të emëruar nga Princi, sidomos ata të shërbimit civil.
Në dallim nga format e zgjedhjeve të aplikuara më vonë, më 1914 parashikohej që, në rast të numrit të barabartë të votave, nuk kishte balotazh, por zgjedhje të fituesit me short. Kurse, në dallim nga periudha e drejtimit të qeverisë së Vlorës, mosha minimale për t'u zgjedhur rritej nga 25 në 30 vjeç, me kushtin që ata të; *"dinë të lexojnë e të shkruajnë shqip".* Kohëzgjatja e organit legjislativ do të ishte katër vjet, aq sa shumica e legjislaturave në modelet tradicionale parlamentare.

[6] Statuti Organik i Shqipërisë, Tiranë 1914.

Ky model zgjedhjeje paraqet një bashkim konceptesh dhe formash midis traditës bashkëkohore evropiane dhe traditës së Perandorisë Osmane.
Konceptet perëndimore kishin të bënin me parimin e zgjedhjeve të lira, të fshehta e konkurruese, me konceptin e një asambleje si pjesë e ndarjes dhe balancës së pushteteve, si dhe me kriteret liberale për kandidim të individëve të interesuar. Pjesë e trashëgimisë osmane ishte ruajtja e organizimit lokal, emërtimeve lokale dhe kompetencave të autoriteteve lokale në zgjedhjet e përfaqësuesve. Pavarësisht nga kjo, sistemi zgjedhor dhe legjislacioni zgjedhor i parashikuar gjatë mbretërimit të Vidit nuk u vu asnjëherë në provë, sepse vetë eksperimenti me princin gjerman zgjati vetëm gjashtë muaj. Pas tij, vendi kaloi në krizë, ndarje të thella dhe pushtim nga pesë-gjashtë fuqi të huaja ushtarake.

Krijimi i institucionit të zgjedhjeve (1921-1924)

Modeli zgjedhor i aplikuar në Kongresin e Lushnjës fillimisht ishte i njëjtë me modelin e vitit 1912, përfaqësues të "zgjedhur" nga krahinat, të gjithë emra të familjeve të mëdha dhe atyre drejtuese në krahinat lokale, për të cilët dhanë miratimin edhe kryetarët e qyteteve e prefekturave. Vetë delegatët e pranuan, në marrëveshje me njëri-tjetrin, këtë model zgjedhor, i vetmi që mund të zbatohej në një vend pa shtet dhe ende pa institucione. Por, kur erdhi rasti për zgjedhjen e Këshillit të Lartë, të qeverisë dhe të Senatit, si më 1912-ën, përsëri u zbatua modeli i zgjedhjeve, votimeve të fshehta, të lira, konkurruese dhe nominale. Mbi bazën e të dhënave të popullsisë, u vendos numri i senatorëve për çdo prefekturë, tetë prefektura me nga katër senatorë, dy të tjera (Lezha, Mati e Krasniqja) me nga dy senatorë.
Menjëherë pas krijimit të parlamentit, zgjedhjes së Këshillit të Lartë dhe të qeverisë, institucionet nisën punën dhe me to nisi edhe "periudha e artë" e parlamentarizmit të parë shumë partiak në historinë e shtetit shqiptar. Pjesë e reformave të reja ishte edhe hartimi e miratimi i ligjit për zgjedhjen e deputetëve. Edhe në ligjin e ri sistemi zgjedhor nuk ndryshon. Përsëri votimet do të ishin [7] *"me ndërmjetësim, d.m.th. me votim të tërthuerum (suffrage indirect)"*, me sistem proporcional preferencial dhe rajonal. Sipas ligjit zgjedhor, vendi ndahej në zona zgjedhore, sipas prefekturave, me numër të përcaktuar vendesh në dispozicion. Çdo qytetar mashkull me moshë mbi 20 vjeç kishte të drejtën e zgjedhjeve, çdo qytetar mashkull mbi 30 vjeç mund të kandidonte. Në çdo 500 banorë zgjidhej një përfaqësues (zgjedhës të dytë). 24 prej zgjedhësve të dytë votonin për zgjedhjen e deputetit. Në këtë mënyrë, çdo deputet u përgjigjej 12 mijë qytetarëve. Në zgjedhjet për zgjedhësit e dytë kishte të drejtë vote çdo qytetar tjetër mbi 25 vjeç, me përjashtim të femrave, me përjashtim të dënuarve, atyre që kanë falimentuar, që nuk kanë paguar taksa dhe të çmendurve. Si zgjedhës të dytë, e drejta për votime u shtohej edhe atyre individëve që nuk

[7] Ligji për zgjedhje të deputetvet, 5.12.1920.

kanë paguar taksat, kurse kufizimet vlenin edhe më tej për të dënuarit për vepra të shëmtuara, ata që nuk kanë të drejta qytetare, që kanë falimentuar, janë të burgosur apo të çmendur. Sipas ligjit të ri, zgjedhjet zhvilloheshin në të njëjtën ditë, në të njëjtat orë, nga ora 9 paradite në orën 5 pasdite, në të gjithë vendin. Parlamenti përbëhej nga 77 deputetë dhe Këshilli i Lartë nga katër anëtarë. Të gjithë deputetët zgjidheshin, ndonëse praktikisht, ashtu si gjatë vitit 1920, një vend iu la përsëri i lirë përfaqësuesit të komunitetit shqiptar në SHBA. Votimi mbetej thuajse i njëjtë: zgjedhësit e dytë të mbledhur në qendra të prefekturave ose nënprefekturave; *"do të jenë të detyruem të shtijnë shortën (pusullën) e tyne prej vrimës së vogël në kuti të mbyllun me vula të nëpunsavet"*. Pusullat duhet që; *"të jenë të vulosuna me vulën e Katundarisë". Ato që dalin prej "kutije pa vulë, nuk do të kenë vleftë. Kutija çilet dhe numrohet shortet"*. Në pusullë secili votues shënon aq emra sa ka vende për në parlament. Nëse shënoheshin më shumë, fleta nuk quhej e pavlefshme, por merreshin për bazë sipas renditjes emërore. Dy zgjedhësit, të parët dhe të dytët;[8] *"në qoftë se dijnë me shkrue duhet qi emnin e zgjedhjes ta shkruejnë me dorën e vet në pusulla; në qoftë se nuk din, të jetë i lir me e shkrue te nji njeri qi kan besim të plotë, i cili do të jetë nga shokët e tij e nga nëpunsat qi ndodhen aty. Nëpunsat do të jen të detyruem me hudhë ma të madhin kujdes qi të mos bahet ndonji padrejtësi për këtë gja".*

Ligji pranon problemet e regjistrimit të popullsisë, sidomos në pjesën veriore dhe verilindore të Shqipërisë (ku përfshihet edhe Kosova), ndaj në nenin 22 të tij, ligji ngarkon qeverinë të përcaktojnë apriori numrin e deputetëve përfaqësues. Për zgjedhjen deputet, përveç kritereve të njohura, duhej që kandidatët të dinin gjuhën shqipe; *"me knim e me shkrim e të mos jetë shërbëtor i kërkujt"*. Kandidimi ishte individual dhe bëhej me një lajmërim të thjeshtë, përfshirë edhe me një telegram drejtuar autoriteteve vendore.

Edhe me këtë ligj u hiqet e drejta e votimit dhe konkurrimit në zgjedhje femrave dhe forcave ushtarake e policore. Ata që kandidojnë, duhet të japin paraprakisht dorëheqje nga postet që kanë. Me dy ndryshime që iu bënë ligjit zgjedhor, u vendos zgjedhja e kushtëzuar e deputetëve në përputhje me raportet ndërfetare të krahinave dhe prefekturave.

Në këtë mënyrë, ligji zgjedhor i vitit 1921 ishte shumë më demokratik, rregullonte deri në detaje procedurat e përgatitjes, zhvillimit dhe administrimit të zgjedhjeve, si dhe krijonte mundësinë dhe lirinë e kandidimit për çdo qytetar që përfshihej në grupet me të drejta elektorale. Ligji u hartua duke marrë përvojë nga ligji elektoral francez, por duke e përshtatur me realitetin dhe kushtet rrethanore në Shqipëri. Qeveria dhe sidomos, Ministria e Brendshme dhe e Drejtësisë, ishin të ngarkuara nga ligji për përgatitjen e procesit dhe administrimin e tij. Pjesë e procesit ishin gjithashtu autoritetet lokale dhe sistemi i gjykatave. Pra, në formë, ligji plotëson kushtet standarde të zgjedhjeve, referuar vitit 1920.

[8] Ligji për zgjedhje të deputetvet, 5.12.1920.

Në praktikë, zbatimi i ligjit pati probleme: fushatat elektorale nuk u zhvilluan vetëm midis kandidatëve të caktuar, kryesisht familjeve të mëdha e të pasura, por edhe midis grupeve të reja politike, që u krijuan vetëm pak muaj përpara zgjedhjeve. Asnjë parti e grupim politik nuk kishte shtrirje kombëtare dhe, aq më tepër, mbështetje kombëtare. Partitë dhe grupimet vepronin kryesisht në ato zona elektorale prej nga ku e kishin prejardhjen figurat kryesore drejtuese të partisë. Për këtë arsye, zgjedhjet e vitit 1921 dhe ato të '1923-shit prodhuan tre grupe parlamentare, dy të partive kryesore politike dhe një grup me deputetë të pavarur, të cilët statistikisht, përbëjnë rekordin historik të deputetëve të pavarur në parlamentin shqiptar. Deputetë të pavarur pati edhe në parlamentin e parë të republikës, me dallimin se zgjedhja e tyre do të ishte e mbështetur nga partia qeveritare, kurse, në zgjedhjet e viteve 1921 - 1923, zgjedhja e individëve të pavarur u bë kryesisht për shkak të autoritetit të madh publik që individë të ndryshëm gëzonin në qytetet përkatëse, sidomos në Berat e Fier.
Zgjedhjet e vitit 1923 për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të duhej të merrte në shqyrtim edhe formën e regjimit dhe të qeverisjes, nuk sollën ndryshime të rëndësishme në sistemin zgjedhor, mënyrën e votimit dhe kriteret e zgjedhjes, të kandidimit dhe të administrimit të votave. Një ndryshim numri ishte rritja e numrit të deputetëve, nga 78 në 95. Zgjedhjet do të ishin përsëri me një raund, zgjedhje kombëtare, sipas modelit proporcional rajonal. Me ligjin e ri elektoral, të miratuar në tetor 1923;[9] *"zgjedhjet zhvilloheshin me votim indirekt, me shkallë të dytë. Për çdo 8000 frymë do të kishte një përfaqësues të zgjedhur, zgjedhja bëhej në prefektura"*.

Në përcaktimin e kritereve të së drejtës apo kufizimeve për pjesëmarrje në zgjedhje u ruajtën thuajse të njëjtat standarde, me ndryshimin e uljes së moshës minimale nga 20, në 18 vjeç. Konkretisht; *"një zgjedhës me të drejtë vote duhej të ishte shtetas shqiptar mbi 18 vjeç, të mos ishte i sëmurë mendor, të mos kishte falimentuar, të dënuarit për krime dhe ata me më shumë se 6 muaj burg, shurdhmemecët, lypsarët, ushtria e gjandarmaria"*. Nga e drejta e votimeve dhe zgjedhjes, edhe këtë herë, mbetën të përjashtuara të gjitha femrat. Një risi e këtyre zgjedhje ishte ndalimi i kandidimit për deputet; "*në të njëjtën prefekturë ata nëpunës dhe oficerë, etj., që punon brenda territorit të saj"*.
Ashtu si në zgjedhjet e vitit 1921; *"nëpunësit dhe zyrtarët e tjerë të lartë, kur kandidonin në zgjedhje, duhej të jepnin dorëheqje nga posti 30 ditë përpara votimeve"*. Kësaj liste iu shtuan edhe funksionarë të tjerë të lartë, siç ishin sekretarët e përgjithshëm të ministrive, shefat e seksioneve në ministri, inspektorët e përgjithshëm etj. Gjithashtu ligji lejoi kandidimin në më shumë se një zonë elektorale të të njëjtit kandidat (neni 29). Duke përfituar nga kjo klauzolë ligjore, Ahmet Zogu konkurroi dhe fitoi njëherësh në dy zona të ndryshme elektorale. Teknikisht, ata persona që dëshironin të kandidonin, e bënin këtë përmes

[9] Ligji për zgjedhjen e misvet të Kuvendit Kushtetues, 10.10.1923

një deklarate, njoftimi me shkrim apo telegram në njësitë vendore, bashki apo prefekturë. Për personat që jetonin jashtë shtetit kandidimi mund të bëhej në përfaqësitë shqiptare jashtë dhe afati për kandidimin ishte 15 ditë përpara zgjedhjeve. Kritere të tilla liberale për kandidimin nuk do të ekzistonin më në asnjë prej formave të reja të regjimeve dhe sistemeve politike, përfshirë natyrshëm edhe periudhën e diktaturës apo të sistemit shumëpartiak të viteve ’90.

Sipas ligjit të ri elektoral, votimi bëhej i fshehtë; *“duke e hedhur votën në një arkë të mbyllur e të vulosur me dyll të kuq, me vulat e anëtarëve të komisionit”* dhe *“me një vrimë sipër saj aq të vogël sa të mundet me u fut bileta e votës”*.

Sipas nenit 42, çdo votues shënonte në letrën e votimit emrat e kandidatëve të tij të preferuar, me kusht që numri i emrave të shënuar të ishte i njëjtë me numrin e deputetëve, që mund të zgjidhen në zonën përkatëse. Kur zgjedhësi shënon më shumë emra sesa kërkohet, atëherë merreshin për bazë emrat, sipas renditjes së shënuar. Deputetët ose anëtarët e rinj të Asamblesë Kombëtare zgjidheshin prej zgjedhësve të dytë, me votim të fshehtë, në qendrat e nënprefekturave. Edhe këtë herë; *“votimi bëhej me bileta uniforme dhe një kartë të bardhë, në të cilën shënoheshin emrat që zgjedhësi mendon se duhet të jenë deputetë”*. Në dallim nga zgjedhjet e mëparshme, ligji parashikonte edhe raund të dytë, në rast të votave të barabarta midis kandidatëve. Përdorimi i shortit për caktimin e fituesit bëhej vetëm nëse, edhe pas raundit të dytë, votat e kandidatëve do të ishin të njëjta. Një risi e ligjit të ri ishte përfshirja për herë të parë të detyrimit që ushtarakët, gjatë ditës së votimit, të qëndronin të mbyllur në kazermat e tyre, si dhe 12 nene me penalitete të ashpra për ata persona që merrnin pjesë në manipulim të zgjedhjeve, falsifikonin vota apo lista zgjedhësish, bënin presione etj.

Edhe në këto zgjedhje, dy ishin subjektet kryesore politike, Partia Demokratike dhe Koalicioni Konservator pro qeveritar. Një grup i tretë, me deputetë të pavarur, fitoi një numër të konsiderueshëm deputetësh, duke u bërë partneri kryesor i Koalicionit Konservator, për krijimin e një shumice parlamentare të qëndrueshme dhe të qeverisë së re. Këto janë të parat dhe të vetmet zgjedhje në historinë e shtetit shqiptar, në të cilat, partia më e votuar, PD-ja e drejtuar nga Noli me 35 deputetët e saj, mbeti në opozitë, kurse partia e dytë politike, Grupimi Konservator i Zogut, me 20-26 vende, krijoi koalicion të qëndrueshëm me deputetët e pavarur, ish-aktivistë të Partisë Popullore.

Fushata e ashpër elektorale dhe bindja e secilit grup politik, se grupi rival politik përfaqëson një rrezik për të ardhmen e parlamentarizmit dhe të vendit, çoi në acarimin e situatës, rrëzimin e dy qeverive dhe, më pas, në ngjarjet dramatike të qershorit 1924. Opozita e bojkotoi shumicën e re parlamentare dhe qeverinë e saj, e akuzoi për manipulime të zgjedhjeve dhe monopolizim të pushtetit. Në këto rrethana, ajo kërkoi rrugë të tjera për të rifituar pushtetin e humbur në zgjedhje. Kjo u bë me ndihmën e komandantëve ushtarakë lokalë, kritikë ndaj qeverisë qendrore dhe me ambicie të mëdha personale për të siguruar më shumë pushtet në qeverisjen qendrore.

Nëse zgjedhjet e vitit 1921 ishin demokratike, por të brishta në kompleksitetin e tyre, ato të vitit 1923 paraqitën shumë më tepër probleme e shqetësime, pati raportime për ndërhyrje të njëanshme të qeverisë në zgjedhje, akuza për manipulim etj. Ironia e fatit e solli që parlamenti i vitit 1923-1924 të prodhonte brenda gjashtë muajsh dy parlamente paralele dhe dy sistemeve të ndryshme qeverisëse. Në parlamentin e parë, me një pakicë prej 20-25 deputetësh, ky institucion nuk funksionoi dhe kryeministri u bë njëherësh ushtrues i funksioneve të Këshillit të Lartë edhe pushtet legjislativ. Në kundërshtim me legjislacionin ende në fuqi, një pjesë e deputetëve mbështetjes së revolucionit morën edhe poste të tjera administrative, gjë që në dhjetor 1924 u konsiderua shkelje e hapur e legjislacionit kushtetues dhe, për pasojë, solli përjashtimin në grup të këtyre deputetëve.

Fundi i zgjedhjeve konkurruese (1925 - 1944)

Me zgjedhjet e vitit 1925 nis periudha e zgjedhjeve formale, me një grupim politik, pa praninë e opozitës dhe nën kontrollin e plotë të autoritetit më të lartë shtetëror, fillimisht presidentit, më pas mbretit, autoriteteve pushtuese italiane e gjermane dhe, për rreth 46 vjet, të regjimit komunist me diktatorin Hoxha në krye.

Të gjitha këto zgjedhje, me dallime të vogla, kanë të përbashkët sistemin zgjedhor, diktatin në emërimin e listave të kandidatëve, kontrollin shtetëror mbi procesin zgjedhor, formalitetin e votimit etj. Dallimet midis tyre mund të gjenden kryesisht në raportet midis deputetëve të emëruar apo të zgjedhur (periudha 1939 - 1946), në ekzistencën e sistemeve një e dy dhomash (1925 - 1928 kishte dy dhoma), në shtrirjen e përfaqësimit edhe në Kosovë (1939 - 1944), në lejimi i kandidimeve të pavarura, por jo opozitare (1925 - 1939), në mungesën e partive politike (1925 - 1939) apo ekzistencën e një partie politike shtetërore (1939 - 1990), në ekzistencën e dy institucioneve paralele (1944) etj.

Teknikisht, sistemi zgjedhor në vitet 1925-1928 mbeti proporcional rajonal, me lista kandidatësh. Një deputet u përgjigjej 15 mijë banorëve, mosha minimale e kandidimit ishte 30 vjeç, cilësia e deputetit nuk pajtohej me funksionet civile, ushtarake e fetare në shtet etj.[10] Të dhëna të veçanta të periudhës së republikës ishin neni 14 i Statutit Themeltar, sipas të cilit, deputeti nuk përfaqëson vetëm qarkun që e ka zgjedhur, por kombin përgjithësisht dhe neni 26, sipas të cilit, *"në kohë të sesionit, deputetet nuk mund të gjinden të burgosun për borxh"*. Numri i deputetëve u ul në 57 dhe, edhe më tej, femrat nuk patën të drejtën e votës.

Ndërkohë, zgjedhjet në senatin e republikës ishin me dy sisteme: me emërim nga presidenti (një e treta) dhe me votim me sistem proporcional rajonal (dy të tretat e senatorëve). Për të qenë senator, duhej të ishe 40 vjeç dhe, në tërësi, të zotëroje cilësitë e deputetit. Në dallim nga modelet e senateve në vendet e tjera, të cilat zbatojnë kriterin e përfaqësimit racional të çdo krahine

[10] Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare, Tiranë 1925.

përbërëse të shtetit, në rastin shqiptar nuk pati kufizime të ndarjeve krahinore. E drejta e presidentit për emërim senatorësh u pa si mundësia më e mirë për të korrigjuar modelin shqiptar të përfaqësimit të krahinave dhe të përkatësisë fetare të senatorëve. Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare, i viteve 1928-1939, ruajti të njëjtin sistem votimi dhe sistemi elektoral.[11] Ndryshimi më i rëndësishëm ishte kalimi në parlament njëdhomësh, pra, edhe eliminimi i senatorit. Deputetët do të përfaqësonin 15 mijë banorë ose 7500 anëtarë të një grupi të veçantë shoqëror. Mandati parlamentar u fiksua katër vjet, u ruajt parimi, sipas të cilit, deputeti përfaqëson kombin, si dhe kriteret e cilësive të kandidatëve për deputet. Edhe në këtë rast, deputeti nuk duhej të ishte funksionar në nivelet e administratës qendrore e lokale. Një përkufizim tjetër, ai i nenit 22, sipas të cilit; *"deputetit nuk mund t'i jepet asnjë porosi urdhërore prej zgjedhësve të vet"*, është interesant për t'u theksuar, pasi, gjatë periudhës komuniste, ky nen do të ndryshohej dhe zgjedhësit do të kishin të drejtë të inicionin e realizonin shkarkimin e deputetëve.

Një risi e modelit të tij ishte kushti i nenit 21, sipas të cilit; *"deputeti nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Parlamentit me rroba fetare. Deputeti nuk mund të marrë në pajtim pasuri të paluajtshme të Shtetit dhe të marrë përsipër provizione ushtarake ose punë botore. Gjithashtu, deputeti nuk mund të marrë në pajtim taksa Shteti"*. Gjithashtu, ashtu si gjatë republikës, edhe gjatë monarkisë, u ruajt përkufizimi se "*në kohën e sesionit, deputetët nuk mund të gjenden të burgosur për borxh; edhe në qofshin, me hapjen e sesionit, lirohen menjëherë"*. Një pikë e imunitetit të zgjeruar parlamentar, në dallim nga sistemet e tjera, ishte neni 27, sipas të cilit; *"vendimet penale që jepen kundër një deputeti nuk zbatohen, derisa vazhdon sesioni parlamentar; kjo kohë nuk llogaritet në parashkrim"*. Gjatë viteve 1939-1943 Italia pushtuese nuk lejoi zhvillimin e zgjedhjeve normale dhe, për pasojë, analiza e sistemit elektoral, ashtu si gjatë pushtimit gjerman, mbetet formale. Baza kryesore ligjore ishte Statuti Themeltar i Mbretërisë i vitit 1939, sipas të cilit, garantohej e drejta e votës për të gjithë territorin shqiptar. Deputetët duhej të ishin mbi 25 vjeç, të gëzonin të drejta politike dhe të kishin kualifikimin e nevojshëm të kërkuar nga ligji. Praktikisht, zgjedhja ishte formale dhe pjesë e parlamentit kukull ishin persona të zgjedhur sipas simpatisë së Partisë Fashiste dhe të autoriteteve pushtuese.

Modeli zgjedhor i vitit 1943-1944 ishte formal përderisa u aplikua në kushte pushtimi. Teknikisht, edhe në këto zgjedhje u praktikua modeli me dy shkallë, sistemi proporcional rajonal, por në një formë të njëjtë me atë të viteve 1912, 1920 apo 1939. Kështu, sipas ligjit të tetorit 1943; *"çdo komunë, qoftë komunë e lidhun në nënprefekturë, qoftë e lidhun në prefekturë, do të zgjedhi nga 3 përfaqësuesa"* dhe këta duhej të zgjidhnin *"asamblistat që do të përfaqësojnë Prefekturën në Asamblenë Kombëtare"*. Një asamblist korrespondonte me 10 mijë banorë dhe kriter i vetëm ishte qenia në moshë madhore dhe gëzimi i të drejtave civile.

[11] Statuti Themeltar i Mbretnisë Shqiptare, Tiranë 1928.

Kalimi në votimet formale e të hapura (1945-1990)

Kushtetuta e vitit 1946 shënoi krijimin e institucionit formal të parlamentit, në një sistem qeverisës monopartiak, të drejtuar e kontrolluar nga Partia e Punës së Shqipërisë. Sipas kësaj kushtetute, ashtu si edhe në modelet e demokracive të reja popullore e socialiste, formalisht sanksionohej fshehtësia e zgjedhjeve, votimi i përgjithshëm dhe e drejta për konkurrim. Ky parim vinte pas atij që e përcaktonte partinë - shtet, si forcën e vetme udhëheqëse. Në dallim nga periudhat e mëparshme, neni 5 sanksiononte[12] se; *"në të gjitha organet e pushtetit shtetëror përfaqësuesit e popullit janë përgjegjës përpara zgjedhësve të tyre"* dhe se *"zgjedhësit kanë të drejtë të revokojnë në çdo kohë përfaqësonjësit e tyre"*.

Sipas ligjit të zgjedhjeve të vitit 1946, sistemi i votimeve do të aplikohej edhe për zgjedhjen e këshillave nacionalçlirimtare të lokaliteteve, nënprefekturave dhe prefekturave. Sipas nenit 2 të këtij ligji; *"kanë të drejtë të zgjedhin e të zgjidhen të gjithë shtetasit shqiptarë pa ndryshim seksi, që kanë mbushur 18 vjeç, përveç atyre që janë të sëmurë nga mendja dhe atyre që u është hequr e drejta e votimit me vendim gjyqi"*. Ligji legjitimonte diskriminimin e së drejtës, duke shtuar se; *"gjithë ata që bëjnë pjesë në Ushtrinë Nacional Çlirimtare, kanë të drejtë të zgjedhin e të zgjidhen, edhe po të jenë më të vegjël se 18 vjeç"*.

Neni 3 sanksionon një model të ri votimi, duke ndryshuar modelin tradicional të monarkisë dhe të republikës, për votime të fshehta. Sipas tij; *"zgjedhjet bëhen me vota të hapëta duke ngritur dorën"*. Çdo 250-300 votues duhej të përcaktonin një përfaqësues për këshillin e nënprefekturës dhe, këta të fundit, zgjidhnin 40-60 anëtarët e këshillit të prefekturës.

Numri i deputetëve të kuvendit rritej nga 101 deri në 250 deputetë dhe, për herë të parë, femrat kishin jo vetëm të drejtën e votimit, por edhe të kandidimit në zgjedhje. Çdo deputet u përgjigjej 10 mijë banorëve dhe sistemi zgjedhor ishte mazhoritar i pastër, por pa kandidatë rivalë dhe me vetëm një listë zyrtare e kombëtare, me kandidatë të emëruar.

Modeli njëpartiak i regjimit komunist u forcua edhe më shumë me Kushtetutën e vitit 1976, e cila sanksionoi rolin udhëheqës të Partisë së Punës. Edhe kjo kushtetutë formalisht angazhohej se'; *"organet përfaqësuese zgjidhen nga populli me votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Zgjedhësit kanë të drejtë të heqin në çdo kohë përfaqësuesin e tyre, kur ky ka humbur besimin politik, kur nuk plotëson detyrat e ngarkuara ose kur ky vepron në kundërshtim me ligjet"*.

Formalizmi i votimeve konkurruese ishte i dukshëm, nëse krahasohet me nenin 3, sipas të cilit, PPSH-ja ishte pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë. Kjo do të thotë se nuk mund të pranohej mendimi ndryshe, organizimi politik konkurrues dhe rivaliteti zgjedhor. Ashtu si edhe gjatë 30 viteve të fundit, edhe pas vitit 1976 proceset zgjedhore u bënë aq të parëndësishme, saqë u shndërruan në një formalitet të panevojshëm. Kështu, më '1970-ën u shënua rekordi i viteve të diktaturës me asnjë votë të pavlefshme, më '1974 pati dy vota të pavlefshme, më '1978-ën u gjetën 3 vota të pavlefshme, kurse "kulmi" arriti në zgjedhjet e vitit 1982, me 9 vota të pavlefshme.

[12] Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1946.

Rikthimi i zgjedhjeve shumëpartiake (1991)

Pas më se 67 vjet mungesë, vetëm në dhjetor të vitit 1990, Shqipëria ligjëroi pluralizmin politik dhe të drejtën për krijimin e sistemit konkurrues të partive politike. Sistemi i ri u huazua nga modelet e vendeve të tjera, kryesisht i demokracive të reja, të cilat prodhuan parlamente me 2-3 parti, por të kontrolluara me shumicë nga një parti e vetme. Kështu, zgjedhjet e vitit 1991 ruajtën sistemin e pastër mazhoritar. Për herë të parë u përcaktua një kufi minimal votash për hyrje në parlament (4%) dhe, në rast të fitores së kandidatit kryesor nën 50% të votave, kalimin në raundin e dytë zgjedhor me kandidatin më të afërt konkurrues.

Ky sistem, për vetë gjendjen politike, sociale dhe ekonomike të asaj periudhe, ishte në favor të dukshëm të partisë në pushtet, Partisë së Punës të Shqipërisë. Me anë të sistemit zgjedhor, ajo arriti të fitojë shumicën absolute të vendeve në parlamentin e parë shumëpartiak dhe të ruante kështu monopolin në zgjedhjen e presidentit, të zyrtarëve të lartë shtetëror dhe në miratimin e ligjeve më të rëndësishme të sistemit të ri politik.

Të dhënat e mëposhtme paraqesin statistikat kryesore të këtyre zgjedhjeve. Ligji zgjedhor ishte ai i vitit 1990, i amenduar dy herë, më 17 dhjetor 1990 dhe, më pas, më 17 janar 1991. Me ndryshimet e reja ligjore, patën të drejtën e konkurrimit partitë politike dhe organizatat e masave. Subjektet duhej të konkurronin me emra nominalë në 250 zona elektorale dhe zgjedhjet u administruan nga një Komision Qendror Zgjedhjesh, i përbërë nga përfaqësues të secilit subjekt politik. Numri i vendeve në parlament mbeti i njëjtë, 250 deputetë. Në këto zgjedhje morën pjesë 11 subjekte politike, pesë parti (Partia e Punës, Partia Demokratike, Partia Republikane, Partia Ekologjike dhe Partia Agrare), një shoqatë politike (Omonia) dhe pesë organizata satelite të PPSH-së (Komiteti i Veteranëve, Bashkimi i Rinisë, Bashkimi i Gruas, Bashkimet Profesionale dhe Fronti Demokratik). Në fushatë u regjistruan 1.074 kandidatë, nga të cilët, 250 nga Partia Demokratike, 243 nga Partia e Punës, 165 nga Partia Republikane, 122 nga Fronti Demokratik, 94 nga Bashkimi i Grave, 94 nga Bashkimi i Rinisë, 37 nga Partia Agrare, 7 nga Komiteti i Veteranëve si dhe 17 kandidatë të pavarur.

Në zgjedhjet u regjistruan 1.984.933 zgjedhës,[13] nga të cilët, zyrtarisht u tha se morën pjesë në votime 1.963.568 votues, ose 98.2% e zgjedhësve. Partia e Punës në pushtet fitoi 56% vota proporcionale, por, për shkak të sistemit zgjedhor, ajo siguroi 169 deputetë ose 67% të vendeve në parlament. Partia Demokratike në opozitë fitoi 38% të votave kombëtare, por vetëm 75 deputetë, numër i barabartë me 30% të vendeve në parlament. Nga subjektet e tjera elektorale rezultat pozitiv shënoi vetëm organizata e minoritetit Omonia, e cila, edhe pse fitoi 0,73% të votave kombëtare, për shkak të koalicionit me PP, siguroi dy mandate parlamentare. Një parti tjetër, Partia Republikane, mori më shumë se dyfishin e votave kombëtare të Omonias, por, për shkak të kufirit zgjedhor, nuk siguroi dot përfaqësim parlamentar.

[13] Afrim Krasniqi"Partitë politike në Shqipëri, 1912 - 2006", Tiranë 2007.

Viti	1991		1992		1996		1997		2001		2005		2009	
	%	Vende	%	Vende	%	Vende	%	Vende	%	Vende	%	Vende	%	Vende
PSSH	56,2	169	25,7	38	20,4	10	8,9	42	52,7	101	41,5	73	40,85	65
PD	38,7	75	62,1	92	55,5	122	7,7	56	25,8	29		32	40,18	68
PLL	-	-	-	-	2,1	-	3,5*	-	3,3	2		5	0,71	-
PBK	-	-	-	-	5,0	2	1,7	-	2,3	1	36,8	3	0,34	-
PR	1,8	-	3,1	1	5,7	3	20,0	11	2,4	1		5	2,11	1
BLD	-	-	-	-	2,0	-	1,1	1	0,8	1		1	0,33	-
PDR	-	-	-	-	-	-	7,4	6	-	-	5,1	6	-	-
PSD	-	-	4,4	7	1,5	-	12,7	7	2,5	9	3,7	4	1,76	-
LSI	-	-	-	-	-	-	8,4	5	-	-	-	-	4,85	4
PBDNJ	0,7	5	2,9	2	4,0	3	4,1	2	2,8	4	2,6	3	1,19	1
PAA	0,1	-	0,6	-	-	-	6,6	4	0,8	1	2,6	3	0,88	-
AD	-	-	-	-	-	-	4,8	3	2,8	2	2,5	3	0,31	-
PDK	-	-	-	-	1,3	-	3,3	2	1,0	1	1,0	-	0,88	-
PDS	-	-	-	-	-	-	4,2	2	-	-	-	-	0,68	-
Pavarur	-	1	-	-	-	-	-	1	-	3	-	2	-	-
të tjerë	2,5	-	1,2	-	2,5	-	5,6	-	2,8	-	4,2	-	-	1
TOTAL	100	250	100	140	100	140	100	140	100	155	100	140	100	140

Zgjedhjet në sistemin e ri kushtetues

Zgjedhjet e dyta politike, ato të marsit '1992, ishin zgjedhje të parakohshme, shumëpartiake, të lira, demokratike dhe me rezultat konkret, rotacionin politik e ndryshimin e sistemit politik në vend. Ligji zgjedhor bëri ndryshime të theksuara në raport me vitin 1991, kryesisht për shkak të interesit dhe presionit të Partisë Socialiste (ish-PPSH-ja), e cila, duke parashikuar humbjen e pushtetit, kërkonte krijimin e një grupi solid opozitar në parlament. Sistemi i ri zgjedhor u afrua me sistemin zgjedhor gjerman, duke krijuar një parlament me 140 deputetë, 100 në zona emërore, pra, në mazhoritar dhe 40 nga listat proporcionale të partive. Kështu, parlamenti i ri do të kishte 110 deputetë më pak se ai i vitit 1991, kurse kufiri i hyrjes mbeti i njëjtë, 4%. Ndërthurja e 100 zonave mazhoritare me 40 mandate proporcionale bëhej për të krijuar një parlament sa më afër vullnetit real të zgjedhësve.

Ky sistem zgjedhor rezultoi i suksesshëm dhe lejoi krijimin e një parlamenti me katër parti politike, por me një parti dominuese me shumicë absolute. Në 100 zonat mazhoritare PD-ja mori 92 dhe PS-ja vetëm 6. PS-ja përfitoi 32 vende në proporcional, nga 40 gjithsej, kurse Omonia ruajti nivelin e dy deputetëve të fituar në mazhoritar. Për shkak të marrëveshjes paraelektorale, PSD-ja, një parti e re politike, siguroi përfaqësim me 6 deputetë në parlament. Për shkak të kufirit të lartë zgjedhor, PR-ja me 3.12% të votave mori vetëm një mandat parlamentar, edhe ky në votim mazhoritar në koalicion me PD-në.

Në lexim statistikor, zgjedhjet e vitit 1992 u bënë me dy raunde dhe me 1.826.142 zgjedhës ose 90,35% të numrit të regjistruar. Në zgjedhje morën pjesë 11 subjekte dhe këto zgjedhje janë të vetmet, në të cilat sistemi zgjedhor dhe legjislacioni zgjedhor

lejoi edhe ndryshime në listën finale shumemërore të partive për deputetë. Kështu, PD-ja, disa muaj pas zgjedhjeve, zhvendosi tre emra në listën e saj shumemërore, duke i zëvendësuar me emrat pasardhës, me argumentin se ata nuk përfaqësojnë më partinë. Kandidatët e mënjanuar u ankuan në Gjykatën Kushtetuese, por kjo e fundit i dha të drejtë PD-së. Një ndryshim tjetër me rëndësi ishte ai i vitit 1992, për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste dhe partive të tjera me program komunist, enverist e marksist. Më '1998-ën, gjykata Kushtetuese e rrëzoi këtë vendim dhe u dha të drejtë komunistëve të krijojnë parti dhe të konkurrojnë në zgjedhje.

Edhe zgjedhjet e vitit 1996 ruajtën të njëjtin sistem zgjedhor, parlament me një dhomë, me 140 deputetë, sistem mazhoritar të korrigjuar me proporcional. Dallimet ishin të vogla, por me ndikim në produktin që dhanë. Numri i zonave në mazhoritar u rrit nga 100 në 115, numri i vendeve në dispozicion në proporcional u ul nga 40 në 25. Në dallim nga viti 1992, u hoq parimi, sipas të cilit, mandatet proporcionale kompensonin partinë e dytë të humbur në mazhoritar, si dhe kufiri hyrës në parlament mbeti i njëjtë, 4%. Një rol të rëndësishëm në zgjedhje luajtën disa kufizime për kandidim, të lidhura me ligjet antigenocid dhe të pastrimit të figurave të zyrtarëve, përmes të cilit u penalizuan shumë eksponentë politikë të lidhur me sistemin e kaluar dhe shërbimin e tij sekret.

Statitikisht, KQZ-ja njoftoi se rezultati i zgjedhjeve ishte: PD-ja 122 vende ose 87% të vendeve, 10 vende ose 7% për Partinë Socialiste, 3 vende ose nga 2% për partitë Republikane dhe atë të Bashkimit për të Drejtat e Njeriut dhe 2 vende ose 1.5% për Ballin Kombëtar. Në proporcional, rezultoi se PD kishte fituar "55.5% të votave ose 32.5% më shumë se përqindja e vendeve në parlament". Shprehur me përqindje, PS-ja mori 20.4% të votave ose 13.4% më shumë, sesa përqindja e vendeve në parlament. Sipas të dhënave zyrtare, numri i votave të vlefshme ishte 1.646.481, me pjesëmarrje 89% në raundin e parë dhe me rreth 250.000 vota të pavlefshme ose 13% e votave totale. Në total, nga të dhënat e shpallura pas tre raundeve të votimeve, në zgjedhje morën pjesë 1.676.609 votues, nga të cilët 1.092.469 ose 65.16% votuan për PD-në.

Zgjedhjet e vitit 1997, ashtu si ato të vitit 1992, ishin zgjedhje të parakohshme dhe prodhuan rotacion politik në vend. Sistemi zgjedhor mbeti i njëjtë, ndryshimet me vitin 1996 ishin të vogla në dukje, por me pasoja në përmbajtje. Kështu, u hoqën kufizimet e kandidimit në zgjedhje (ligji antigenocid dhe ai i dosjeve), kufiri hyrës në parlament u ul nga 4 në 2%, numri i deputetëve u rrit nga 140 në 155.115 në mazhoritar dhe 40 nga lista proporcionale. Edhe këto votime u bënë në dy raunde dhe, për herë të parë, të gjitha partitë hynë në koalicione të mëdha. Partitë e majta krijuan një koalicion të përbashkët, fillimisht në emrin Forumi për Demokraci dhe më pas Aleanca për Shtetin. Forcat e qendrës së djathtë politike krijuan Bashkimin për Demokraci, kurse partitë e djathta u grupuan në E djathta e Bashkuar Shqiptare (DBSH).

Risi e këtyre zgjedhjeve ishte përfshirja në listën shumemërore të partive të mëdha (PD) të figurave drejtuese të partive aleate (PBL, PDK, PBD), model që do të aplikohet gjerësisht më '2001 dhe '2005. Statistikisht, zgjedhjet shënuan fitoren e koalicionit të majtë (PS-ja 101 deputetë, PSD-ja 9 deputetë, PAD-ja 2 deputetë etj.), ndaj koalicionit të djathtë, të kryesuar nga PD-ja, me vetëm 27 deputetë.

Zgjedhjet parlamentare të viteve 2001 dhe 2005 kanë si veçori mbështetjen e tyre në sistemin e ri zgjedhor, të vendosur në Kushtetutën e vitit 1998. Sipas Kushtetutës, parlamenti do të ishte me 140 deputetë, të zgjedhur 100 drejtpërdrejt dhe 40 nga listat shumemërore. Kushtetuta futi parimin e balancimit, sipas të cilit; *"numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve".* Ajo sanksionoi kufirin minimal 2.5% të hyrjes në parlament për partitë dhe 4% për koalicionet, si dhe përfshiu organin e administrimit zgjedhor, KQZ-në, në listën e institucioneve të rëndësishme jopartiake dhe kushtetuese. Prova e parë e sistemit të ri ishin zgjedhjet e vitit 2001, të cilat. përmes modelit të "Dushkut", kalimit të votave proporcionale të partisë së madhe për aleatët e vegjël. me qëllim sigurimin prej tyre të mandateve shtesë në proporcional.

Statistikisht, zgjedhjet e vitit 2001 shkuan në pesë raunde, në to morën pjesë 1.323.900 zgjedhës, konkurruan 1.114 kandidatë partiakë e 149 të pavarur. Në këto zgjedhje u angazhua Gjykata Kushtetuese, e cila shqyrtoi dhe dha vendime për 59 zona elektorale, numër rekord në historinë e zgjedhjeve shqiptare. Kryetema e zgjedhjeve u bë zona 60 në Lushnjë, ku PS-ja në raundet e fundit ndihmoi në proporcional partitë aleate, PAD-në, PAA-në e PBDNJ-në. Këto të fundit, me ndihmën e këtyre votave, siguruan kalimin e kufirit për hyrje në parlament dhe, kështu, 9 mandate parlamentare nga listat shumemërore. Pa këtë zonë elektorale, raportet midis së majtës e së djathtës ishin 80 me 60, por me zonën 60, raportet kaluan në 88 me 52, pra, katër vota më shumë se minimumi i nevojshëm për zgjedhjen e Presidentit të Republikës dhe për miratimin e kodeve në parlament.

Modeli i "Dushkut" i vitit 2001 u zgjerua së tepërmi në zgjedhjet e vitit 2005. Dy partitë e mëdha e aplikuan atë masivisht, duke e cilësuar skemë taktike në përputhje me frymën kushtetuese. Për pasojë, dy partitë e mëdha luftuan për zonat në mazhoritar, kurse të gjitha votat e tyre kombëtare në proporcional, me thirrje publike, ua kaluan partive të vogla aleate. Për pasojë, PD-ja e PS-ja fituan 56 e 42 vende në mazhoritar, ndonëse në votim kombëtar ato morën vetëm 7,6% dhe 8,8% të votave. Me votë kombëtare dhe skemën taktike të ndjekur nga dy partitë e mëdha, PR-ja ishte fituese e zgjedhjeve me 20% e ndjekur nga PSD-ja me 12%. E vetmja parti e tretë fituese në mazhoritar (Lëvizja Socialiste për Integrim, 1 deputet), humbi më shumë se 3-4 mandate nga kjo skemë e ndjekur nga partitë e mëdha.

Viti i Votimit	Zona	Sistemi Zgjedhor	Votimi Shkallë	Numri Raundeve	Zgjedhje emërim	Pragu %	Forma e largimit	Natyra e zgjedhjeve
1912	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Nuk funksionoi	Të zakonshme
1914	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Miks	0	Nuk funksionoi	Të parakohshme
1921	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1923	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Krizë zgjedhjeje	Të zakonshme
1925	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të parakohshme
1928	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të parakohshme
1932	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1936	10	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1939	14	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Miks	0	Fund pushtimi	Të parakohshme
1943	14	Prop. preferc. rajonal	Me dy shkallë	Një raund	Miks	0	Fund pushtimi	Të parakohshme
1945	82	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1950	121	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1954	134	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1958	188	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1962	214	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1966	240	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1970	264	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1974	250	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1978	250	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1982	250	Mazhoritar	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1987	250	Mazhoritar	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	0	Zgjedhje	Të zakonshme
1991	250	Mazhoritar	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	0	Ndryshim sistemi	Të parakohshme
1992	100	Mix (Pr-mazh)	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	4	Zgjedhje	Të parakohshme
1996	100	Mix (Pr-mazh)	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	4	Zgjedhje	Të zakonshme
1997	115	Mix (Pr-mazh)	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	2	Zgjedhje	Të parakohshme
2001	100	Mix (Pr-mazh)	Votim direkt	Dy raunde	Zgjedhje	2.5	Zgjedhje	Të zakonshme
2005	100	Mix (Pr-mazh)	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	2.5	Zgjedhje	Të zakonshme
2009	12	Proporc. rajonal	Votim direkt	Një raund	Zgjedhje	3	Zgjedhje	Të zakonshme

Veçori e rëndësishme e zgjedhjeve të vitit 2005 ishte aplikimi për herë të parë i zgjedhjeve me një raund, sipas parimit britanik: fiton ai që është i pari në renditje. Risi ishte gjithashtu numërimi i përqendruar i votave, aplikuar kjo për herë të parë. Në tërësi, veçori e sistemit elektoral të viteve 2001 dhe 2005 ishte gjithashtu aplikimi i listave të hapura për partitë e vogla politike. Sipas këtij parimi, renditja e vendeve bëhej pas zgjedhjeve, në varësi të rezultatit zgjedhor nominal për çdo zonë. Kjo formë votimi rriti ndjeshëm konkurrimin dhe interesin e individëve për t'u angazhuar në fushatë në listat e partive të vogla dhe ndikoi në copëtimin e ndjeshëm të votave midis partive.

Zgjedhjet e vitit 2009 u aplikuan me një sistem tjetër zgjedhor, proporcional rajonal. Për herë të parë, në historinë 19 vjeçare, kandidatët për deputetë erdhën nga listat partiake, jo nga votimet direkte nominale të qytetarëve. Sistemi i ri synoi të eliminojë defektet më serioze të zgjedhjeve të mëparshme, sidomos skemat taktike (modeli "Dushk"), të ulë kostot

financiare, të ulë numrin e partive parlamentare, të minimizojë incidentet dhe të krijojë një sistem bipolar, por në kushtet e listave partiake, pra, me prurje të sigurta të politikanëve të karrierës.

Në dallim nga sistemi proporcional universal, Shqipëria aplikoi modelin rajonal, tipik për vendet federative dhe me probleme etnike apo të ndarjeve të theksuara sociale e fetare. Sistemit i mungoi komponenti kombëtar, ndaj edhe votat e partive nën kufirin e një mandati elektoral rajonal nuk u përkthyen në mandat kombëtar, por u shkuan dy partive të mëdha. Gjithashtu, këto zgjedhje, ashtu si ato të vitit 1991, janë të vetmet në të cilat votuesi ka vetëm një votë, kështu që probabiliteti për trafikimin e kësaj vote midis partive nuk funksionoi, por pushteti i një vote u përdor nga individë biznesmenë, për të aplikuar në masë të gjerë blerje votash. Kjo praktikë shënoi një hap prapa në standardet e zgjedhjeve dhe ndikoi në uljen e besimit e të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje.

Zgjedhjet e '2009-ës, për herë të parë, prodhuan dy parti solide me diferencë minimale votash dhe mandatesh, përkatësisht 10 mijë vota dhe vetëm dy mandate. Partia më e votuar mori më pak mandate, sepse një rol thelbësor në ndarjen e mandateve luajti koalicioni paraelektoral. PD-ja përfitoi rreth 100 mijë vota nga 15 aleatët në koalicion, ndaj 68 mijë votave të përfituara nga PS-ja prej katër partive të tjera në koalicion. Ky kalkulim elektoral bëri edhe diferencën në zgjedhje. Ndërkohë, zgjedhjet rikonfirmuan një parti të tretë politike, LSI-në, e cila, për shkak të formulave të përllogaritjes së votave, nga 84 mijë vota fitoi vetëm 4 mandate, dy herë më pak sesa proporcionaliteti i votave për një mandat. Rreth 10 parti parlamentare nuk arritën të fitojnë një mandat përfaqësimi, por parlamentit iu shtua një parti e re parlamentare, PDI, parti lokale e suksesshme, sidomos në komunitetin çam në Vlorë dhe në Fier.

Baza ligjore e vitit 2009 ishte strikte dhe refuzuese ndaj çdo nisme për kandidim të pavarur. Ligji kërkonte nënshkrimet e një të dhjetës së zgjedhësve të një zone, shoqëruar ato me akte noteriale dhe, për pasojë, me një faturë të madhe financiare. Në këto rrethana, zgjedhjet '2009 paraqesin rastin e vetëm kur në zgjedhje konkurroi vetëm një kandidat i pavarur, edhe ai një përfaqësim simbolik i rrjetit të OJF-ve, që trajtojnë problemet e qytetarëve me aftësi të kufizuar. Kodi Zgjedhor premtonte hapësira apelimi, verifikimi, vëzhgimi etj., por, realisht, procesi shfaqi probleme të mëdha në fazën e fundit, atë të numërimit të votave dhe opozita vuri fillimisht në dyshim e më pas kontestoi rezultatin final, të prodhuar nga disa zona rajonale. Kështu, sistemi proporcional rajonal solli ndryshime të mëdha në sistemin politik në vend, por nuk arriti të shmangë traditën e vjetër të problemeve dhe të kontestimit të zgjedhjeve.

Konkluzioni mbi sistemet e aplikuara zgjedhore

Ndryshimet e reja kushtetuese të vitit 2008 i dhanë fund ciklit të eksperimenteve me sisteme dhe formula të ndryshme zgjedhore. Nga sistemi i pastër mazhoritar i vitit 1991 u

kalua në sistemin proporcional rajonal, pa mbrojtje të votës kombëtare dhe me lista të mbyllura. Në sistemin e ri, kufiri minimal për hyrje në parlament luhatet nga 4.5 në 24%, në varësi nga rajoni dhe mbetet i kështillueshëm aplikimi i koalicioneve masive paraelektorale. Për shkak të angazhimeve si vend aspirant dhe, pas disa vitesh, anëtar në Bashkimin Europian, por, për shkak të demografisë së popullsisë brenda e jashtë vendit, do të jetë e pritshme që, pas një ose dy mandatesh parlamentare, sistemi zgjedhor të ndryshojë përsëri, nga proporcional rajonal në proporcional kombëtar.

Në përfundim të analizës për sistemet dhe përvojat zgjedhore të viteve 1912-2009, vlen të theksohet fakti se institucioni i zgjedhjeve nuk ka ende një traditë të qëndrueshme demokratike. Ato vuajnë nga ndryshimet e vazhdueshme të sistemit zgjedhor, ndërhyrja e theksuar për deformimin e këtij institucioni prej partive politike, mungesa e koherencës dhe e besueshmërisë, distanca e thellë midis parimeve kushtetuese dhe zgjedhjeve në praktikë, rivaliteti i ashpër dhe boshllëku i madh në kulturën demokratike ndërmjet aktorëve kryesorë politikë, si dhe problemet e mëdha të legjimitetit.

Tipar i përbashkët i të gjitha sistemeve të aplikuara zgjedhore në vendin tonë është mungesa e kushteve reale për aplikimin tërësor e cilësor të tyre. Çdo regjim i përdori zgjedhjet për të ruajtur vazhdimësinë e tij, çdo qeveri dëshmoi vullnet të madh për të kontrolluar proceset zgjedhore të radhës. Vitet 1921-1923 dhe vitet 1992-2009 mbeten periudhat e vetme të konkurrencës reale shumëpartiake. Të vetmet zgjedhje demokratike dhe të pranueshme nga aktorë të politikës pjesëmarrëse janë zgjedhjet e vitit 1921 dhe ato të vitit 1992, pra, vetëm dy procese zgjedhore me distancë 71-vjeçare. Problemet më të mëdha dhe mangësitë e proceseve zgjedhore dhe të legjitimitetit të tyre janë ato që lidhen me pasojat që ato sollën në vetë ecurinë e sistemit politik dhe legjitimitetin e institucioneve drejtuese të tij. Kriza e rëndë politike e vitit 1924 dhe ajo e vitit 1997 patën si burim politik ankesat dhe protestat për manipulim të proceseve zgjedhore paraardhëse.

Problemet zgjedhore shfaqen edhe në aspektin e ngushtimit gjithnjë e më të madh të ushtrimit të zgjedhjes direkte. Më ‘1991, të gjithë deputetët zgjidheshin nominalisht dhe direkt, më ‘2010 asnjë institucion qendror (parlament, qeveri, president) nuk votohet direkt nga qytetarët. Për shkak edhe të mungesës së përvojës dhe shanseve për ushtrim në forma të tjera të demokracisë direkte, problemi i ushtrimit direkt të vullnetit të popullit mbetet një sfidë thelbësore për të ardhmen. Tendencat e vendeve të tjera me sisteme proporcionale, përfshirë fqinjët tanë në Maqedoni, Kosovë, Serbi, Malin e Zi, Kroaci, Bullgari e Rumani, për kompensimin e këtij defekti përfaqësimi me zgjedhjen direkte të institucionit të presidentit, morën përgjigje negative me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008. Një rrugëzgjidhje optimale do të duhej të ishte krijimi i mekanizmit

të votimeve periodike në formën e demokracisë direkte (referendume lokale e kombëtare) për çështje të ndryshme me interes madhor, si një mekanizëm i përfaqësimit më të madh, rritjes së besimit tek institucionet politike dhe i edukimit qytetar me kulturën e zgjedhjes.

Bibliografia:

1. Afrim Krasniqi "Sistemet partiake dhe sistemet politike", Tiranë 2008.
2. Afrim Krasniqi "Partitë politike në Shqipëri", Tiranë 2007.
3. Aleks Luarasi "Çështje të historisë dhe të shtetit të së drejtës", Tiranë 1999.
4. Aurela Anastasi "Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri, 1912-1939", Tiranë.
5. Elez Biberaj "Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy", USA 1998.
6. Luan Omari "Sistemi parlamentar në Shqipëri", Tiranë 1998.
7. Njazi Jaho "Reforma zgjedhore", Tiranë 2004.
8. Rein Taagepera "Votat dhe mandatet: efektet dhe përcaktuesit e sistemeve zgjedhore, Tiranë 2004
9. Kushtetutat e Shqipërisë (1914-2008).
10. Kodi Zgjedhor ne Republikën e Shqipërisë (1991-2009).